



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 24-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 30. 10. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës

4. Avni Olluri, drejtor i DA
5. Shkelzen, Hajdini, drejtor i DEZH
6. Rasim Hasani, drejtor i DKA
7. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
8. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
9. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
10. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
11. Bekim Shabani, drejtor i DRKS
12. Visar Kozhani, zyrtar i DBF-s
13. Vlorë Limani-Hajnuni DSHMS
14. Vlorë Krasniqi, zyrtarë ligjorë
15. Lumniqe Ejupi, sektori pronator juridik
16. Bukurie Zejnullahu, zyra e informimit
17. Besart Troshupa, zyra e informimit
18. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHK"
19. Kimete Jashanica, OSBE
20. Bestar Ibrahim, i
21. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 27 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 23-të Kuvendit.
2. Propozim vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive.
3. Raporti gjashtëmujor janar-qershor 2019 i punës së Zyres së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.
4. Raporti i shpenzimeve janar-shtator 2019.
5. Propozim Vendim për organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale.
6. Propozim vendim për formimin e komisionit për kordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale.
7. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksit 15Nr. 011-29428 e datës 02.05. 2019.
8. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare
9. Propozim vendim për miratimin e planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Meqë vërejtje nuk pati rreth rendit të ditës Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se 27 vota për, kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Lulzim Rrustemi, unë i përgëzoj të gjithë qytetarët për një proces demokratik dhe fer ndërsa fituesve ju uroj suksese.

Kam një pyetje deri ku ka mbërri strategjia e zhvillimit komunal. Kam edhe një kërkesë për DSHP, që të merrë masa pasi që është koha e vjeshtës dhe të parku prapa çerdhes kur është bërë

meremetimi i parkut është mbyllë kanali i ujërave të shiut dhe aty kemi grumbullim të ujërave të shiut.

Ramiz Qeriqi, edhe unë i uroj fitoren Vetëvendosjes po ashtu ju uroj edhe deputetëve të LDK-së që janë zgjedh nga Lipjani. Kam disa pyetje: te tregu i kafshëve çka është duke u punuar. Kam një kërkesë të qytetarëve që te marketi “Interex” të bëhet një dalje pasi që qytetarët po janë të detyruar të shkojnë te Suhadolli për t’u kthyer. Ka qenë edhe një kërkesë për një lapidaryë të Bashkim Krasniqit nuk e di deri ku ka shku kjo kërkesë. Kanalizimi në Krojmir a do të rregullohet më frik. Është shkruar nëpër portale se për eskursionin e nxënësve në Shqipëri nuk kanë fituar kompanit nga Lipjani deshta të pyes pse nuk kanë fituar këto kompani nga Lipjani por nga një vend tjetër.

Albulena Kelmendi, kam disa pyetje: e para ka të bëjë rreth çështjes së ujit ku na keni njoftuar se është caktuar një task forcë, deshta të pyes se deri ku ka shkuar puna e këtij komisioni dhe a ka ndonjë raport të tyre për gjendjen në teren. Po ashtu kohën e fundit kompanitë e autobusëve i kanë rritë çmimin e biletave dhe të mujoreve në relacionin Lipjan-Prishtinë çka do të ndërmarrë komuna lidhur me këtë çështje? Deshta të pyes edhe rreth punimeve në renovimin e shkollës “Adem Gllavica” deri ku kanë mbërri punimet. Çështja e fundit që kam për ta ngritur është rreth orarit të autobusëve pasi që nxënësit e shkollave deri më tani e kanë pasur orarin e orës 40 minuta, ndërsa tani është rritur për 5 minuta dhe këta nxënës po duhet të vrapojnë për t’i nxënë autobusët dhe kjo tash në kohën e dimrit por edhe që është ndërrua ora mund të jetë fatale për këta nxënës, a ka ndonjë plan komuna rreth kësaj çështje?

Egzona Bytyqi, si profesioniste shëndetësore më ka brengos fakti pse komuna e Lipjanit nuk ka vazhduar me kampanja vetëdijësuese në luftë kundër kancerit, siç kanë qenë në vitin e kaluar disa aktivitete që kanë qenë për t’u admiru. Çështja tjetër aparati diagnostifikues-mamografia a është funksional. Kam një pyetje për drejtoratin e arsimit a kanë qenë panelist në grupin taskforcën e organizuar nga ministria e arsimit në luftë kundër përdorimit të narkotikëve.

Nehat Tërpeza, kam dy çështje për t’i ngritur: e para kërkoj nga ekzekutivi të bëjë sinjalizimin e rrugëve siq është rruga Ribar i Madh-Torinë. Çështja tjetër ka të bëjë me shkollat e futbollit të cilat po i zhvillojnë ndeshjet gjatë orarit të shkollës, kërkoj nga DKA dhe DKRS, të marrë veprime më konkrete që mos të mungojnë nxënësit gjatë orarit të mësimi.

Argjend Tasholli, kam disa çështje për t’i ngritur: gropat e krijuara nga ujësjellësi në rrugën “Ilirida” në Gadime kush e ka për detyrë t’i riparoj? Po ashtu pyetje tjera rreth asfaltimit dhe ndriçimit siq janë rrga “Bahri Fazliu” dhe rruga Martirët e fshatit në Resinovec, rruga lagja Hajrizi në Gumnasellë, rruga “Muharrem Duli” në Gadime. Pyetja tjetër pasi që jemi në stinën e vjeshtës a janë ndërmarrë hapat për kontraktimin e kompanive për pastrimin e rrugëve?

Nazmi Krasniqi, është një kërkesë e qytetarëve në veçanti e shitësve që tregu mos të largohet nga vendi ku është tani pasi që bizneset e tyre po dëmtohen.

Afrim Miftari, edhe unë i uroj të gjithë qytetarët për procesin zgjedhor fer dhe demokratik, po ashtu fituesve ju uroj suksese. Kam një pyetje për DKA-në që ka të bëjë me dokumentacionin e humbur siq janë: diftesat dhe diplomat, a ekziston ndonjë udhëzim admimistrativ që i lehtëson këto procedura për marrjen e dokumentacionit të nevojshëm?

Fehmi Rexhepi, kam një pyetje për drejtoratin e shëndetësisë: pse stamatologu në Magurë nuk po punon dhe ne si qytetarë po detyrohemi të vijmë në Lipjan? Pyetja tjetër ka të bëjë me dy shtylla elektrike të cilat janë në lagjen e komunitetit e të cilat mund të shkaktojnë problem për ata banorë pasi që ato i mbanë vetëm një fije e hollë e kablllos dhe kërkoj nga ana e juaj që kjo çështje të merret parasyshtë pasi që edhe në KEDS më herët kemi bërë një kërkesë për këtë çështje.

Bashkim Budakova, kam një kërkesë të banorëve të fshatrave Rubovec i Madh, Rubovec i Vogël, Kojskë dhe Llughaxhi që te rruga Rubovec-Lipjan të rregullohet rruga te ura e Gllgovciti.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, edhe unë ju uroj qytetarët për kulturën e treguar gjatë procesit zgjedhor po ashtu edhe fituesve ju uroj suksese.

Sa i përket parkut prapa Qerdhes si problem duhet të evidentohet. Strategjia e zhvillimit ekonomik është në dëgjim publik dhe në séancën e ardhshme do të jetë në Kuvend.

Te tregu i kafshëve po ndërtohet një palestër sportive e madhe që është kontratë 3 vjeçare.

Hapja e rrugës të “Interexi” nuk mund të bëhet pasi që sipas ekspertëve nuk mund të hapen rrugë çdo 20 metra. Sa i përket lapidarëve është e pa mundur të aprovohen kërkesat për secilin veç e veç por e kemi idenë për disa raste të tilla. Në vazhdim të sheshit do të provojmë me nxjerrë një pllakë perkujtimore. Te eskursionet te nxënësit e thërras publikisht hetuesinë, prokurorinë që ta hetoj këtë rast pasi që unë nuk i kam detyruar askëndë të shkoj në një vend apo në vendin tjetër. Janë të lirë nxënësit me shku ku të dojnë. Një ndër çështjet më serioze që u ngrit në këtë séance është çështja e ujit të pijshëm, një problematikë që na pret në vitet në vazhdim. Ujësjiellësi nuk i jep kurfarë llogarie komunave. Puset të cilat i kemi në Lipjan janë të pa mjaftueshme, ndërsa puset te ferma e pulave janë në teritorin e Graçanicës. Ne kemi pasur dy takime me kompaninë e ujësjiellësit por do të kemi prap një takim tjetër të premtën. Çmimi i biletave të autobusëve është që i përket autoritetit rregullativ të konkurrencës. Renovimi i shkollës “Adem Gllavica” sipas kontratës do të përfundoj në janar. Sa i përket ndërrimit të orës ka ndiku te nxënësit por ne ju kemi drejtu me shkresë ministrisë dhe ata ende nuk na kanë kthyer përgjegje. Ndërsa orari i autobusëve është bërë në bazë të një konkursi të shpallur. Sinjalizimi i rrugëve nuk mund të bëhen të gjitha por do të shohim mundësitë në ditët në vijim. Shkollat e futbollit nuk është përgjegjësi e komunës me i ndalë por, aktivitete gjatë orarit të mësimi nuk i lejojmë të kenë. Sa i përket largimit të tregut të gjelbërt aty asnjë herë nuk ka pas vendim që të ketë treg por ne prap nuk do ta largojmë tregun prej aty pasi që do të jetë treg ditorë por do të largohen vetëm ditën e hënë tregëtarët të cilët më shumë janë jashtë Lipjanit e shumë herë po i bllokojnë trotuarin edhe rrugën me pemë dhe perime të tyre.

Rruga Rubovc-Kojškë-Lipjan do të shohim mundësinë për riparimin e asaj rruge.

Vlora Limani-Hajnuni, ju falenderoj të gjithëve për urimet. Unë në çdo AMF dhe QMF e kasha dërgu nga një stomatolog por ajo caktohet nga niveli qendror. Sa i përket kampanjës kundër kancerit të gjirit edhe këtë vit kemi pas, por ka qenë pak më e zbehët. Mamografi është për momentin në defekt dhe po kemi problem riparimin pasi që janë të modelit më të vjetër. Prej vitit të ardhshëm në QMF do të kryhen analizat biokimike.

Albulena Kelmendi, ankesat për ujë të pijshëm vijnë më së shumti prej rasteve sociale te Eurokosi ku pronari nuk i lejon ata banorë me vendos a rezervar të ujit. Të paktën këtyre qytetarëve do të duhej t`ju lejohej që t`i vendosin rezervarët në podrumin e ndërtesës.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 23-të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes 23-të dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 23-të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshme

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Sefer Tasholli, drejtor i DGJK-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi .

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, kam disa pyetje e para do kishte qenë mirë që përmes projektorit të na sqarohet rruga. Pyetja e dytë a është ky shpronësim shtesë që i bëhet qytetarëve, deri ku shkon kjo rrugë dhe a shpronësohet edhe rruga “Qamil Olluri” apo vetëm “Bejtush Gërbeshi”.

Sefer Tasholli, kjo pikë ka qenë më herët të cilën e kemi spjeguar përmes projektorit por është vetëm një shpronësim shtesë dhe kjo rrugë do të vazhdoj prej stadiumit deri te Gllgovci.

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 27 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM PËR SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK PËR SHPRONËSIM TË PALUAJTSHMËRIVE

Neni 1

Miratohet Vendimi për shpalljen e interesit publik për shpronësim shtesë të paluajtshmerive të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga projekti për ndërtimin-asfaltimin e rrugëve “Bejtush Gërbeshi” dhe “Qamil Olluri” në Lipjan, sipas listes së pronave të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqet e tyre të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativë nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

Neni 3

Obligohet Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të zhvilloj procedurat e shpronësimit në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati i Shërbimeve Publike.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

III

Raporti gjashtëmuor Janar-Qershor 2019 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Ahmetit, Kryetar i Komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Hyra Bytyçi, në këtë raport janë të paraqitura të gjitha sfidat dhe të arriturat me të cilat është ballafaquar zyra e kryetarit dhe ekzekutivi. Ky raport ofron transparencë dhe llogaridhëje nga ana e ekzekutivit karshi qytetarëve në përgjithësi. Ne si grup parlamentar i LDK-së vlerësojmë rritje pozitive të dinamikës së punës e cila është arritur si rezultat i menagjimit efikas të parasë publike në implementimin e shumë projekteve për ta përmirësuar mirëqenien

ekonomike të qytetarëve në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, administrative, edukative shkollore, zhvillim ekonomik etj.

Çështja kryesore që e ka veqar këtë vit punën e ekzekutivit përkatësisht DBF-së është realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë prej 53.58% krahas planifikimit. Ne e përgëzojmë ekzekutivin dhe e inkurajojmë për punën dhe angazhimin më të mirë dhe jemi për t'ju ofruar mbështetjen dhe bashkëpunimin tonë.

Lulzim Rrustemi, sa i përket raportit ne kemi disa vërejtje por është për t'u përshëndetur të hyrat nga tatimi në pronë, por edhe të hyrat vetanake. Në shumicën e drejtorateve mungojnë sfidat me të cilat përballlet ekzekutivi. Pak janë prek zonat komerciale e Babushit dhe QMI, po ashtu edhe në Kleçkë. Po ashtu mungojnë vizitat e Kryetarit jasht vendit. Është mirë të ceket në raportet e ardhshme raporti Komunë-Qeveri, cilat janë pengesat, sfidat.

Majlinda Sylejmani, sa i përket këtij raporti ka qenë mjeft i kjtartë dhe i detajizuar mirë. Ajo çka është më e rëndësishmja drejtoratet komunale siç janë: zhvillimi ekonomik, arsimi, shëndetësia dhe administrata kanë treguar një angazhim të madh për rritjen e shërbimeve në dobi të qytetarëve. Ku deshta t'i përmend disa punë të drejtorateve siç janë ai i shëndetësisë ku është bërë recepcioni, emergjenca dhe sistemi i digjitalizimit. Në administratë sistemi i menagjimit të radhës ku kjo ju ka ndihmuar shumë qytetarëve. Në Arsim vendosja e sistemit të kamerave, ndërsa te zhvillimi ekonomik tregon përformancën më të mirë nga USAIDI për konkurushmeri.

Nazmi Krasniqi, një raport i detajizuar mirë por i mungojnë sfidat ku te shëndetësia ka përparim në aspektin teknik por ka vërejtje te stafi mjekësorë në veçanti në vise rurale ku stafi mjekësorë ndodh që edhe hiq mos të shkoj në punë. Po ashtu edhe te arsimi përveq punëve teknike nuk po arrijmë të kemi arsim cilësor. Ku pothuajse në të gjitha shkollat testi i arritshmërisë nuk ka arritë as 50% të kalueshmërisë. Po ashtu nuk kemi një Ligj për penzionim të parkohëshëm ku kemi prej stafit arsimor që ndoshta nuk është i gatshëm aq sa duhet ta kryej detyren. Po ashtu kemi numër të madh të mungesave qoftë nga cikli i ulët por edhe ai i mesëm.

Afrim Miftari, konsiderojmë një raport në bazë të pasqyrave reale por ajo që vlenë të përmendet është të hyrat nga tatimi në pronë, por edhe infrastruktura në sholla dhe QKMF. Sfidë është ndërhyrja e thesarit. Edhe ne konsiderojmë që në raportin e ardhshëm duhet të paraqiten raportet Komunë-Qeveri.

Lumturije Bytyqi - Hasani, kam një vërejtje te zyra e protokolit pasi që kjo i paraqet vetëm të hyrat por asnjëherë nuk i paraqet takimet e kryetarit. Pyetja e dytë ka të bëjë me shëndetësi për ashensorin në QKMF që nuk ka filluarë kurfar procedure dhe kjo po ju shkakton probleme qytetarëve për EKG dhe Rengen, a do ta ket shëndetësia një ashensor të tillë. Pyetja e fundit ka të bëjë me kontratën sektoriale ku punëtorët shëndetësorë nuk gëzojnë pagën për punën gjatë vikendeve të cilën e garanton Ligji por as pagën jubilarë. A keni marrë ndonjë hap për me i realizu këto të drejta të cilat po i mohohen punëtorëve shëndetësorë.

Egzona Bytyqi, deshta të marrë një informatë për strategjinë për kujdesje parësore shëndetësore a kemi marrë ndonjë rekomandim nga MAPL-ja dhe a është kthyer interpretimi. Pyetje tjeter ka të bëjë me QMF në Shalë rreth nxemjes ku është nevojë esenciale.

Fehmi Rexhepi, unë deshta ta falenderoj kryetarin e komunës z. Imri Ahmeti për punën që ka bërë për komunitetin po ashtu edhe nënkryetarin z. Qerimi dhe them se është një raport që shumë i ka ndihmu komunitetit tonë, do ta ketë përkrahjen e komunitetit tonë dhe veç të vazhdon përpara.

Vlora Limani-Hajnuni, sa i përket ashensorit kemi bërë kërkesë në DBF dhe vitet në vijim do të hynë në agjendë edhe ashensori. Të gjitha ordinancat mjekësore e kemi zbritë në katin përdhësë, po ashtu edhe dhomën e infuzioneve dhe ineksioneve, laboratorin. Nërsa radiologjinë presim me e zbritë te polmologjia. Sa i përket kontratës kolektive ajo po bëhet nga Ministria e Arsimit së bashku me Ministrinë e Financave ku neve nuk po na lejojnë që të planifikojmë për këtë çështje. Strategjia ka shku për interpretim në ministrinë dhe do të fillon të zbatohet nga viti 2020. Ndërsa ngrohja në QMF në Shalë është në procedurë të prokurimit.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se është e drejtë ajo që e thanë parafolësit sa i përket sfidave ato duhet të specifikohen për secilin sektorë. Në zonat ekonomike jemi jo mirë pasi që ka mungu mbështetja nga Qeveria. Ndërsa sa i përket raportit me Qeverinë dhe organizata tjera të gjitha janë të evidentuara.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati u kalua në pikën e katërt të rendit të ditës.

IV

Raorti i shpenzimeve janar-shtator 2019

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, një raport i paraqitur mjaft detalisht, sipas fondit burimor një shpenzim mjaft i vogël të investimeve kapitale dhe subvencioneve. Te grantet qeveritare shpenzimi mjaft i vogël, po ashtu edhe te donacionet një shpenzim i vogël. Në total, në përgjithësi, shpenzimi i buxhetit është i vogël dhe egziston edhe brengosja. Sipas kategorive ekonomike po ashtu kemi shpenzim të vogël. Sipas të hyrave vetanake edhe këtu kemi shpenzim të vogël. Të hyrat vetanake të bartura edhe këto jo të shfrytëzuara mirë. Granti qeveritar te Shërbimet Publike edhe këtu janë shpenzime të vogëla. Po ashtu edhe te Bujqësia dhe Zhvillimi Rural një shpenzim mjaft i vogël. Te shëndetësia kemi shpenzim pak më të mirë, ndërsa te arsimi parafillor kemi shpenzim më të rritur. Në total nëse shikohet te arsimi kemi një shpenzim të mirë. Te arsimi 10 mijë euro janë parapa por nuk janë shfrytëzu për çka janë parapa këto mjete?

Te mirëmbajtja e veturave, karburantet dhe telefonia kemi rritje të shpenzimeve.

Te shpenzimet tjera kontraktuale po më intereson për cilat shpenzime bëhet fjalë?

Latif Ramadani, ne kemi paraqitur një raport real të shpenzimeve. Sa i përket bujqësisë mjetet janë duke u nda në teren, ndërsa kemi edhe projekte që janë kontrata dy vjeçare. Shërbimet tjera kontraktuale përfshihen mirëmbajtja e komunës, mirëmbajtja e parçeve etj.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi dha pauzë nga ora 12,⁰⁷ deri në ora 13,³⁰

V

Propozim Vendim për organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Vlora Limanit-Hajnunit, drejtoreshë i DSHMS-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE DHE KRYETARËVE TË KËSHILLAVE LOKALE

Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohet që Organizimi i zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale në territorin e Komunës së Lipjanit të fillojë në fillim të muajit janar të vitit 2020 dhe të përfundojë me datë 31 mars të vitit 2020.

Neni 2

Komisioni i Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale do t'i kryej të gjitha detyrat, përkritazi me organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave të lokale në pajtim me dispozitat e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019

Neni 3

Për mënyrën e sigurimit të mjeteve të nevojshme financiare për organizimin e zgjedhjeve të cekura do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim vendim për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Vlora Limanit-Hajnunit, drejtoreshë i DSHMS-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Fazlija, unë kam një kërkesë që edhe Nisma të ketë një përfaqësues në këshillë pasi që vetëm Nisma nga opozita po jet pa përfaqësues.

Daut Azemi, pa përfaqësues në këtë këshill janë edhe AKR,PD e PAI dhe na kemi dashtë me pasë një gjithëpërfshirje pasi që nëse e shikojmë LDK-së do t'i takonin 2 anëtarë.

Majlinda Sylejmani, ne si grup i LDK-së e propozojmë Hyra Bytyçin.

Lumturije Bytyqi-Hasani, ne si grup e propozojmë Argjend Tashollin.

Albulena Kelmendi, ne si grup e propozojmë Shkelzen Bislimin.

Ganimete Qeriqi, ne si grup e propozojmë Bashkim Budakovën.

Nazmi Krasniqi, tha se në këtë këshill a duhet të respektohet kuota gjinore?

Daut Azemi, tha se në komision duhet të respektohet kuota gjinore pasi që do të shkoj për interpretim në ministri dhe mund të na kthehet negativisht.

Albulena Kelmendi, unë për vete jam në KPF dhe përfaqësues tjetër nga gjinia femërore ne nuk kemi por pres nga partitë tjera të bëjnë ndonjë ndryshim, pasi që po e dijmë që mund të na kthehet negativisht.

Vlora Limani-Hajnuni, çështjen e përfaqësimit e kemi edhe në Rregulloren të cilën e kemi votu në Kuvend dhe është mirë që na me reflektu e mos me na u kthy negativisht.

Arben Salihu, mua po më duket e pa arsyeshme me shku me një propozim të tillë pasi që po e dijmë që na kthehet negativisht.

Albulena Kelmendi, përfaqësuesi nga shoqëria civile a është caktuar.

Daut Azemi, po nga shoqëria civile është Denis Gashi.

Lulzim Rustemi, ne po e bëjmë një ndryshim në vend të Argjend Tashollit po e propozojmë Lumturije Bytyqi-Hasani.

Bashkim Budakova, unë po tërhiqem dhe po e propozoj për anëtare të komisionit Ganimete Qeriqin.

Daut Azemi, Kryesues, tha se tani komisioni ka këtë përbërje:

Hyra Bytyçi, LDK
Lumturije Bytyq-Hasani, PDK
Shkelzen Bislimi, VV
Ganimete Qeriqi, AAK
Avni Olluri, nga ekzekutivi
Denis Gashi, nga shoqëria civile dhe
Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal, anëtar.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 27 votat për, 2 kundër aprovoi këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË KËSHILLAVE LOKALE

Neni 1
Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim formohet Komisioni për koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit në përbërje si vijon:

1. Hyra Bytyçi, nga subjekti politik LDK, Kryesuese
2. Lumturije Bytyqi-Hasani, nga subjekti politik PDK, anëtare
3. Shkelzen Bislimi, nga subjekti politik LVV, anëtar
4. Ganimete Qeriqi, nga subjekti politik AAK, anëtare
5. Avni Olluri, nga ekzekutivi i Komunës, anëtar
6. Denis Gashi, nga shoqëria civile, anëtar
7. Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal, anëtar

Neni 2
Mandati i anëtarëve

Mandati i Komisionit është i lidhur me me mandatin e Kuvendit të Komunës.

Neni 3
Detyrat e Komisionit

Komisioni Komunal ka për detyrë të organizojë zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane si dhe të kryej detyra tjera të përcaktuara me dipozitat e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019.

Neni 4
Kompensimi i punës së komisionit

Për punën e tij Komisioni do të kompensohet në vlerë prej 30 € (tridhjetë euro) për pjesëmarrje në secilin takim të mbajtur në fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane i cili do të evidentohet në procesverbal. Pagesa do të bëhet nga buxheti i Komunës –kategoria ekonomike- mallra dhe shërbime.

Neni 5
Punët administrative - juridike të Komisionit

Punët administrative - juridike të Komisionit do t'i kryej Drejtorati për Administratë - Sektori për punë të Kuvendit dhe të Komiteteve.

Neni 6 **Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr. 011-29428 e datës 02.05. 2019.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Ilir Tasholli, drejtor i DSHP-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nehat Tërpeza, ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Rregullore dhe kjo vetëm çka ja lehtëson punën taksistëve.

Lulzim Rrustemi, edhe ne jemi për kushte më të mira për këtë veprimtari dhe është një ndihmë e mirë që po ju bëhet taksive. Por kam një pyetje nuk e di që pse është bërë ndryshimi te nenin 6 anëtarët e komisionit duhet të jenë 5, në Rregulloren e mëhershme ka qenë se përveç 3 anëtarë nga komuna duhet të jetë një anëtar ekspert nga kontrolla teknike dhe një polic pse është bërë ky ndryshim.

Ilir Tasholli, e kemi pas planifikuar që përveç anëtarëve nga komuna në komision të jetë edhe një anëtar nga qendra e homologimit dhe një anëtar nga policia por e kemi pa që është pak e vështirë pasi që ata anëtarë deshirojnë të kenë edhe meditje dhe ne nuk kemi mundësi ta bëjmë e kjo ka qenë arsyeja e vetme.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 28 votat për, aprovoi këtë:

RREGULLORE **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TRANSPORTIN E** **UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI 15NR.011-29428 E DATËS 02.05.2019**

Neni 1

1.Qëllimi i miratimit të kësaj Rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i nenit 5 paragrafi 1.5, nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 12 paragrafi 1.1 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-29428 të datës 02.05.2019 (në vazhdim të tekstit Rregullorja).

2. Neni 5 paragrafi 1.5 i Rregullores riformulohet si vijon:

Ngjyra e automjeteve taksi mund të jenë të ndryshme me kusht që automjetit t'i vendoset një shirit identifikues me ngjyrë bardhë e zi, sipas standardeve duke përjashtuar automjetet taksi që operojnë në aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" të cilat duhet të jenë të ngjyrosura vetëm me ngjyrën e bardhë.

3.Neni 6 paragrafi 1 i Rregullores riformulohet si vijon:

Kryetari i Komunës merr Vendim për shpalljen e Njoftimit publik për dhënien e licencave dhe formon Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve dhe verifikimin e automjeteve. Komisioni do të jetë në përbërje prej 5 anëtarëve.

4.Neni 12 paragrafi 1.1 i Rregullores, riformulohet si vijon:

1.1 Operatorët të cilët operojnë në qytetin e Lipjanit të kenë të ngjyrosur automjetin me cilën do ngjyrë të përzgjedhur nga operatori me kusht që automjetit t'i vendoset një shirit identifikues me ngjyrë bardhë e zi sipas standardeve, ndërsa operatorët të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" të kenë të ngjyrosur automjetin me ngjyrë të bardhë, të regjistruar, teknikisht në gjendje të rregulltë si dhe pa dëmtime në pjesën e jashtme dhe të brendshme të automjetit.

Neni 2

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Rregullorja.

VIII.

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Vlora Limanit-Hajnunit, drejtoreshë i DSHMS-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe propozojmë që të vazhdohet me raste të tilla në vazhdim.

Albulena Kelmendi, edhe ne në emër të grupit parlamentar të VV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe është për t'u përshëndetur, shpresojmë që do të ndihmohen disa familje dhe të zvogëlohen nevojat e tyre.

Hyra Bytyçi, edhe ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe urojmë që edhe më tutje të ketë propozime të tilla.

Afrim Miftari, edhe ne si grup parlamentar i AKR-së i japim mbështetje këtij propozim vendimi dhe konsiderojmë që është një mesazh i mirë që edhe të tjerët t'i bashkangjiten një iniciative të tillë.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 50,000 € (pesëdhjetë mijë) euro, me destinim për subvencionimin –ndërtimin e shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë sociale në Komunën e Lipjanit.

II. AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës që menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të negociojë dhe të lidhë Marrëveshje bashkëpunimi me organizatat e ndryshme të shoqërisë civile vendore, ndërkombëtare apo donatorët e ndryshëm për bashkëfinancim në ndërtimin e shtëpive për familjet me kushte të rënda sociale.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës-kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

X

Propozim vendim për miratimin e planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi i njoftoi të pranishmit për planin orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 14,¹⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi